

Emri i Lëndës : Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 415	C	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Ferdinand Xhaferaj, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Dy çështje themelore debatoen vashdimisht në nivel global: Pse kombet luftojnë dhe pse ato bashkëpunojnë me njeri tjetrin? Një teori e gjith-përhapur (realizmi) prezanton konfliktin si një sjellje normale në problematikat ndërkombëtare. Një tjetër teori (liberalizmi) karakterizon bashkëpunimin si një normë sjellje në raportet ndërkombëtare. Kjo lëndë është projektuar që t'i prezantoj studentëve njohuritë bazë që kërkohen për të kuptuar marrëdhëniet ndërkombëtare dhe organizatat kryesore ndërkombëtare. Pra, kjo lëndë trajton rolin e organizatave ndërkombëtare në institucionalizimin e bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Studentët do ta nisin lëndën duke shqyrtuar disa aspekte teorike të nevojshme për të kuptuar marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këndvështrimin teorik ne do të shpjegojmë elementët bazë të teorive realiste, liberale dhe konstruktiviste. Më tej, ne do të bëjmë një analizë të krahasuar të teorive kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo konsiderohet e rëndësishme për të paisur studentët me aftësi diagnostikuese të nevojshme për të kuptuar dhe studiuar organizatat kryesore ndërkombëtare. Gjatë zhvillimit të lëndës ne do të shpjegojmë origjinën historike të organizatave kryesore ndërkombëtare, mënyrën se si ato janë strukturuar dhe funksionet bazë të tyre. Më tej, ne do të shqyrtojmë ndikimin e aktorëve lokal dhe ndërkombëtar ndaj organizatave ndërkombëtare. Mbasi të shpjegojmë qëllimin, arritjet dhe dështimin e Lidhjes së Kombeve ne do të analizojmë organizatat kryesore ndërkombëtare që u krijuan mbas Luftës së Dytë Botërore. Me mbarimin e lëndës studentët do të zotërojnë instrumentat analitikë dhe konceptualë të nevojshëm për të kuptuar sjelljen e aktorëve kryesorë në sistemin ndërkombëtar. Qëllimi final i lëndës është paisja e studentëve me dije të qëndrueshme lidhur me funksionimin e organizatave kryesore ndërkombëtare.					
Objektivat		Qëllimi final i lëndës është që të rrisi njohuritë e studentëve lidhur me aftësinë e tyre për të njohur dhe analizuar organizatat ndërkombëtare. Në përfundim të trajtimit të lëndës studentët mastër do të zotërojnë: 1. një njohuri të qëndrueshme të teorive kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe vecoritë e tyre 2. një kuptim të plotë pse organizata të ndryshme ndërkombëtare ekzistojnë 3. një njohuri të plotë për organizatat kryesore ndërkombëtare 4. një njohuri të kënaqshme lidhur me mënyrat se si organizatat ndërkombëtare influencojnë iniciativat e shteteve 5. një aftësi të konsiderueshme për të kuptuar mundësitë në dispozicion të organizatave ndërkombëtare 6. një njohuri të konsoliduar që do t'i bëjë studentët të aftë të projektojnë dhe ekzekutojnë një projekt lidhur me organizatat ndërkombëtare.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Prezantim i zhvillimit të lëndës, i termave dhe çështjeve që do mbulohen si edhe do te trajtohen konceptet bazë që do percillen gjatë gjithë lëndës						
2	Cfarë është politika, studimi i politikës; llogjika, përjasjet dhe metoda						
3	Cfarë janë marrdheniet ndërkombetare						

4	Teoritë kryesore të marrëdhënieve ndërkombetare: Realizmi
5	Liberalizmi dhe konstruktivizmi
6	Zhvillimet historike dhe krijimi i lidhjes së kombeve
7	Arritjed dhe dështimet e lidhjes së kombeve
8	Provim Gjysmëfinal
9	Kombet e Bashkuara: origjina, qëllimi dhe struktura
10	Ndërhyrjet humanitare. Rast studimi: ndërhyrja humanitare në Kosovë (1999)
11	NATO dhe siguria Evropiane: Principet bazë të NATO-s dhe objektivat
12	Struktura dhe funksionet e NATO-s
13	Cfarë është Bashkimi Evropian: Zhvillimet historike dhe themelimi i Bashkimit Evropian
14	Principet baze, struktura dhe funksionimi i Bashkimit Evropian
15	Globalizmi si rendi i ri ndërkombetar
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Elmas Leci. Organizatat dhe institucionet Nderkombetare. 2011 • John Baylis and Steve Smith, "The Globalization of World Politics: an Introduction to International relations" (6 edition, Oxford University Press 2014) • Robert O. Keohane (ed), "Neorealism and its critics" (Columbia University Press 1986) • Ian Hurd. International Organizations POLITICS, LAW, PRACTICE. Cambridge University Press. • Jan Shapiro. The Moral Foundations of Politics. Yale University Press. • Lecture notes available after the class	
Referenca të tjera	
• Joseph S. Nye, "The Future of Power" (Publik Affairs New York 2011) • Luisa Blanchfield. United Nations Reform: U.S. Policy and International Perspectives. Congressional Research Service: www.crs.gov	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Me plotësimin e kësaj lënde studentët do të dëshmojnë njohuri të konsoliduar lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe organizatat kryesore ndërkombëtare
2	Studentët do të jenë në gjendje të njohin mënyrat dhe përjasjet me të cilat konceptet kryesore dhe teoritë janë përdorur për të analizuar fenomenet politike, institucionet dhe sjelljen e tyre.
3	Studentët do të fitojnë një dimension praktik për të projektuar një projekt kërkimor lidhur me çështje të organizatave ndërkombëtare

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	35	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			35
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			65
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	10	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			140
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.60
ECTS			6.00